



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
MINISTRIA E KULTURES  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 470 Prot.

Tiranë, më 03.04.2018

**VENDIM Nr. 82, datë 20.03.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërbimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.4, datë 20.03.2018, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor "Kërkim në terren për rrënoja arkeologjike në fshatin e Nivicës", në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtuese Olgita Ceka, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor "Kërkim në terren për rrënoja arkeologjike në fshatin e Nivicës", në kuadër të Shkollës Doktorale të Arkeologjisë*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Akademia e Studimeve Albanologjike), drejtuese Olgita Ceka, paraqitur nga Instituti Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

- a) Vëzhgim në terren me metoda teknike të përparuara, në qëndrat:
- "Maja e Seferajve"
  - Salari (Tepelenë)
  - Matohasanaj (Tepelenë)
  - Dukaj (Tepelenë)
  - Kuç (Vlorë)
  - Vermik (Vlorë)
- b) Hartimi i një pasqyre të detajuar të historisë dhe arkeologjisë të fshatit Nivicë dhe të rrethinave të tij:
- Sondazhe arkeologjikë në rast konstatimi strukturash ose depozitime antike;
  - Kërkim në terren për rrënojat arkeologjike në fshatin Nivicë;

---

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: +355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)

- Nxitja e interesimit të bashkësisë lokale për mbrojtjen e trashëgimisë arkeologjike.

c) Puniimet në terren:

- Puna në terren do të kombinojë metoda të shumta arkeologjike, duke përfshirë sondazh arkeologjik, rilevim me anë të fotogrametrisë dhe imazheve 3D, vizatime nga kërkimi në terren ose nga gërmimet dhe analizë e gjetjeve;
  - Identifikimi i shtresave arkeologjike në "Majën e Seferajve" ku supozohet vendndodhja e strukturave arkeologjike. Një sondazh 3mx3m do të saktësojë stratigrafinë;
  - Testimi i teknikave të rregjistrimit me anë të fotogrametrisë 3D të statigrafisë dhe të artefakteve të rëndësishme, të cilat do të përpunohen, regjistrohen kategorizohen dhe analizohen;
  - Hartimi në shkallë të gjërë dhe regjistrimi i karakteristikave arkeologjike në rrithinat e fshatit Nivicë duke kryer fushata në terren të koordinuara me të dhënat *lidar*.
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë ajo e nevojshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2018.
  3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
  4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.
  5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
  6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.



SEKRETARI KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: +355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)